



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall:

KONKURS (i Brendshëm)

Titulli i pozitës: Drejtor i Drejtorisë për Miratimin e Projekteve të Zhvillimit Rural

Ref: RN00002992

Njësia Organizative: Drejtoria e Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural- AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli drejtues

Koeficienti: 10

Qëllimi i vendit të punës:

Drejtori i Drejtorisë së Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural është përgjegjës për organizimin, menaxhimin dhe kordinimin e punës së drejtorisë në procesin e implementimit të programit për PZHR. Ndjek procedurën e kontrollit administrativ për miratimin e projekteve dhe është përgjegjës për ndarjen e funksioneve dhe detyrave brenda drejtorisë dhe nivelet e raportimit.

Detyrat kryesore:

1. Udhëheqë dhe cakton objektivat e drejtorisë në përputhje me strategjinë dhe objektivat e AZHB-se dhe dizajnon planet vjetore të punës të detajuara për ti përmbushur këto objektiva 20%
2. Menaxhon stafin dhe buxhetin e drejtorisë dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit ; 15%
3. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme duke përgatitë raporte për rezultatet e përkrahjes dhe rekomandon ndryshime, përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë; 15%
- 4 Zbatimi i skemave përkrahëse të programit për zhvillim bujqësor dhe rural, dhe zbatimi i procedurave të përcaktuara 15%
5. Përgatitja dhe rishikimi i formulareve për aplikim, listave të kontrollit dhe rishikim ,aprovim ose ndryshim i kontratave për projektet e përzgjedhura në përputhje me kërkesat 10%
6. Bashkepunon me drejtorite tjera në AZHB dhe koordinon procesin e aplikimit me sektorët relevant 10%
7. Mbështet përgatitjen e rregulloreve për përkrahje në koordinim me sektorin ligjor të AZHB-së dhe përgatit materiale informative për përfituesit potencial në koordinim me AM dhe DSHK(MBPZHR).10%
8. Bën vlerësimin e stafit dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve 5%

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

Njohuri paraprake ne fushën e zhvillimit rural;

Diploma Universitare: **Shkenca të Ekonomisë, Bujqësi ose Relevante;**

Përvoja në punë: 6 vite përvojë pune profesionale - 3 vite përvoj në vende udheheqese; Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point,Access)

Fleksibilitet dhe aftësi për t'u përballë me situata të reja;

Shkathtësi ne menaxhim, organizim, caktim te objektive dhe planifikim;

Njohja e gjuhës angleze e preferuar.

Data e shpalljes së konkursit me: 06.04.2018

Data e mbylljes së konkursit me: 13.04.2018

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 16 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së www.azhb-ks.net.